



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 4018 Prot.

Shkodër, më 20/03/2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA SHËNDETËSORE RRETHINA
SHKODËR

Nr. 89 Prot.

Shkodër, më 20/3/2023

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
BASHKISË SHKODËR
DHE
QENDRËS SHËNDETËSORE RRETHINA, AMBULANCA “SHTOJ I VJETËR -TË
RRITUR DHE PEDIATRI”, SHKODËR**

E lidhur sot me datën ____ . ____ .2023, mes palëve:

BASHKIA SHKODËR e përfaqësuar nga Kryetari **Z. Bardh SPAHIA**.

QENDRA SHËNDETËSORE RRETHINA SHKODËR, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri”, me Nr NIPTI K76312015H, përfaqësuar nga **z. Sabah Sylo**, me Nr. ID G90223098K.

BAZA LIGJORE: Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet në bazë të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligji nr. 8744 date 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar;

OBJEKTI: Dhënia në përdorim të një ambienti në Qendrën komunitare “Për Familjen“ Rrethina, Zona Kadastrale 3429, nr. 22/11 ndërtesë me sipërfaqe shfrytëzimi 40 m², sipas planimetrisë bashkëlidhur, e regjistruar në pronësi të Bashkisë Shkodër, për të ushtruar aktivitetin: Dhënie Shërbimi Publik Shëndetësor Parësor.

Palët bien dakort sa më poshtë:

Neni 1

Bashkia Shkodër do t'i japë në përdorim Qendrës Shëndetësore Rrethina, Ambulancës “Shtoj i Vjetër-të rritur dhe pediatri”, pasurinë e përshkruar në objektin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për ta përdorur për veprimtarinë e dhënies së shërbimit publik shëndetësor parësor.

Neni 2

Afati i përdorjes së ambjenteve është 1 (një) vit, nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, me të drejtë rinovimi.

Neni 3

Prona e paluajtshme objekt i kësaj marrëveshje bashkëpunimi pasi është parë nga të dy palët për gjëndjen e saj teknike dhe funksionale, merret në dorëzim nga përfaqësuesi i Qendrës Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri”, Z.Sabah Sylo, i cili garanton se do ta dorëzojë atë si në gjendjen fillestare. Për çdo dëmtim të konstatuar, pala (Qendra Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-të rritur dhe pediatri”) do të përgjigjet me vlerën e plotë të dëmit.

Neni 4

Qendra Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri” do ta përdorë objektin vetëm për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është realizuar kjo marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 5

Qendra Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-të rritur dhe pediatri” merr përsipër të kujdeset për ruajtjen e ambjenteve nga vjedhjet, dëmtimet, zjarri etj, si dhe çdo detyrim tjetër i parashikuar nga dispozitat ligjore në fuqi. Ambjentet e marra në përdorim përbëhen nga 2 dhoma, banjo dhe korridor në përdorim të përbashkët.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e Qendrës Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri”:

1. Qendra Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri”, detyrohet të mbajë dhe t'i ruajë ambjentet me përkujdesje.
2. Qendra Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri”, nuk mund të përdorë ambjentet ndryshe nga përdorimi i caktuar në marrëveshjen e bashkëpunimit.
3. Qendra Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri”, nuk mund t'ia japë një të treti ambjentet për përdorim pa pëlqimin e Bashkisë Shkodër.
4. Qendra Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri”, është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin e ambjenteve objekt i kësaj marrëveshje bashkëpunimi, përveç kur provon se humbja ose dëmtimi i sendit do të kishte ndodhur edhe në rast se nuk do të ishte dhënë në përdorim.

5. Qendra Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri”, gjatë gjithë kohës së përdorimit të ambjenteve objekt i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është e detyruar që të lidhë kontratat dhe paguajë me shpenzimet e veta detyrimet e faturave të energjisë elektrike dhe ujit, në rast të kundërt do të ketë sanksione deri në prishjen e marrëveshjes së bashkëpunimit.
6. Qendra Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri”, është e detyruar që të paguajë me shpenzimet e veta shërbimet e mirëmbajtjes së zakonshme të ambjenteve në përdorim përveç kur në marrëveshjen e bashkëpunimit është parashikuar ndryshe.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Shkodër :

1. Bashkia Shkodër jep në përdorim ambientin e ndodhur në Qendrën komunitare “Për Familjen“ Rrethina, Zona Kadastrale 3429, nr.22/11 ndërtesë me sipërfaqe shfrytëzimi 40 m² e regjistruar në pronësi të Bashkisë Shkodër, për të ushtruar aktivitetin: Dhënie Shërbimi Publik Shëndetësor Parësor.
2. Kur Qendra Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri”, nuk përmbush detyrimet e lartpërmendura, Bashkia Shkodër mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të ambjentit, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar.
3. Nëse Qendra Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri”, përdor ambjentet ndryshe nga sa është caktuar në marrëveshjen e bashkëpunimit ose nga natyra e tij dhe për një kohë me të gjatë se sa duhej, përgjigjet për humbjen e ndodhur edhe nga rasti faktor, përveç kur provon se sendi do të humbiste njëlloj, si të mos përdorej ndryshe, si të ishte kthyer në kohën e caktuar në marrëveshjen e bashkëpunimit.
4. Kur mbaron afati i marrëveshjes së bashkëpunimit ose kur marrëveshja e bashkëpunimit zgjidhet para këtij afati, Qendra Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri”, është e detyruar t'i kthejë Bashkisë Shkodër ambjentet po në atë gjëndje në të cilën i ka marrë me ndryshimet e zakonshme të shkaktuara nga përdorimi i tyre, ose në gjëndjen e parashikuar në marrëveshjen e bashkëpunimit. Gjersa nuk provohet e kundërta prezumohet se ambjenti është marrë në gjëndje të mirë.
5. Bashkia Shkodër merr përsipër dorëzimin e objektit me anë të një procesverbali të nënshkruar nga palët e kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 8

Në rast se midis palëve do të lindin mosmarrëveshje, të cilat nuk do të mund të zgjidhen në mirëkuptim midis tyre, atëherë secila nga palët ka të drejtë t'i drejtohet organeve kompetente, në mbështetje të legjislacionit në fuqi për zgjidhje.

Neni 9

Në rast se ndonjë nga palët e kësaj marrëveshje bashkëpunimi pengohet të përmbushë të gjitha ose një nga pjesët të detyrueshme të saj të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi si pasojë e forcës madhore, kjo palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohëzgjatjes së forcës madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe që rrjedhin nga forcat madhore.

Pezullimi i ekzekutimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi si pasojë e forcës madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e forcës madhore.

Neni 10

Kjo marrëveshje bashkëpunimi quhet e lidhur me nënshkrimin e saj nga palët.

Dispozita te fundit

Neni 11

Çdo korigjim i marrëveshjes së bashkëpunimit pas nënshkrimit të saj e bën atë të pavlefshme.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi u hartua në katër kopje origjinale e cila pasi u lexua palëve, u pranua dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të plotë e të lirë.

Për Bashkinë Shkodër

Z. Bardh SPAHIA

Kryetar

Për Qendrën Shëndetësore Rrethina

Ambulanca "Shtoj i Vjetër-Të rritur dhe pediatri"

Z. Sabah Sylo

Drejtor